

Manjola ZAÇELLARI – Valter MEMISHA

EMËRTIMET E SHKURTUARA NË MEDIAN E SOTME

Hyrje

Çështja e shkurtesave në gjuhën shqipe është trajtuar në punime të veçanta nga disa autorë, ndër të cilët do të veçojmë studiuesit: Hasan Çipurin¹, Drita Garucin², Engjëll Angonin³, Rami Memushajn⁴, Hajri Shehun⁵, Valter Memishën⁶ etj., të cilët gjatë parashtrimeve të tyre shkencore pohojnë se tashmë përdorimi i emërtimeve të shkurtuara është një dukuri shumë e njohur. Madje, sipas prof. Memishës nuk ka fushë të veprimtarisë dhe të dijes njerëzore ku këto lloje njësisish gjuhësore të mos shfaqen dhe ndonjëherë përdorimi i tyre shpesh shkon në skajshmëri.

Shkurtesat janë universale gjuhësore; funksioni i tyre nominativ se vjen e rritet, pasi nëpërmjet tyre u jepen emra të rinj nocioneve dhe realieve të njohura. Shkurtesat u ngjajnë fjalëve, por nuk janë ekuivalente me to, megjithëse kanë shumë tipare të përbashkëta. Struktura semantike e shkurtesave është e ndërlikuar dhe shpesh kanë konotacione specifike.

¹ Çipuri, H. (1988). “Shkurtesat dhe vendi i tyre në terminologjinë e sotme të gjuhës shqipe”, *Studime filologjike*, n. 3, f. 132-145

² Garuci, D. (1972). *Mbi drejtshkrimin e shkurtimeve*, në Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, Tiranë, f. 475-476.

³ Angoni, E. (1989). “Shkurtesat dhe drejtshkrimi i tyre”, *Gjuha jonë*, 3, f. 22-23.

⁴ Memushaj, R. (2002). *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, f. 154-158.

⁵ Shehu, Sh. (1999). *Teknika e leximit në gjuhën angleze*, Tiranë, f. 76.

⁶ Memisha, V. (2008). *Emërtimet e shkurtuara në shqipe*. Tiranë, f. 9-85.

Shkurtesat nuk kanë vetëm vlerë gjuhësore, por edhe historike, pasi mund të përmbajnë edhe elemente arkaike. Ato nuk janë njësi gjuhësore të krijuara artificialisht për ekonomi gjuhësore, por janë njësi që eliminojnë kontradiktën midis vetëdijes moderne dhe burimeve të kufizuara leksikore të çdo gjuhe.

Shkurtesat janë veçanërisht të zakonshme në gjuhët evropiane. Ato kanë barasvlerëse në shumë gjuhë të tjera, por nuk janë aq të shumta sa në gjuhët moderne evropiane⁷. Ndryshimet e mëdha shoqërore dhe përparimi shkencor dhe inxhinierik (faktorët jashtëgjuhësorë) janë faktorë që ndikojnë dukshëm lindjen e shkurtesave. Megjithatë, parimi i “me sa më pak përpjekje” ose “ligji i kursimit të të folurit” shpjegojnë formimin e tyre⁸.

Kontradikta e vazhdueshme midis nevojave njerëzore në komunikim dhe dëshirës për të minimizuar përpjekjet mendore dhe fizike mund të konsiderohet si forca lëvizëse e ndryshimit të gjuhës. Si në shumë raste të tjera, sjellja personale lidhet me parimin e përpjekjes më të vogël, sipas të cilit një folës sforcohet vetëm në masën e nevojshme për të arritur një qëllim specifik⁹.

Shkurtesat si njësi që studiohen nga semantika

Semantika e njërive gjuhësore, ndonëse ka shumë punime për këtë çështje, është deri tani një nga fushat më të thella dhe

⁷ Espersen, O. (1946). *A Modern English Grammar on Historical Principles*. Part VI. Morphology. London, 550-551; Lipka, L. (2013). *Observational linguistics, neologisms, entrenchment, and the Tea Party Movement*. Brno studies in English. 36, 1; Trask, L. (2014). *A student's dictionary of language and linguistics*. Routledge.

⁸ Martine, A. (1963). *Fundamentals of general linguistics*. Journal of New in linguistics, 3, 532-533; Serebrennikov, B.A. (1983). *On materialistic approach to phenomena in language*. Journal of Science, Moscow, 319; Lipka, L. (2013). *Observational linguistics, neologisms, entrenchment, and the Tea Party Movement*. Brno studies in English. 36, 1.

⁹ Kondratyukova L.K. (1980). *Computer technologies' formation and development*: Dissertation of PhD in Philology, 17; Marchuk, Y.N. (1992). *Fundamentals of computer-based translation*, 75.

më enigmatike të gjuhësisë. Një interes të veçantë shpërfaq semantika e shkurtesave të gjuhës angleze, për shkak se shërben si një nga burimet kryesore aktuale të huazimit të shkurtesave nga gjuhët e tjera. Si rrjedhojë, siç do ta shohim edhe më poshtë, edhe për gjuhën shqipe huazimi nga anglishtja është më i përhapuri.

Duke qenë se shkurtesat janë njësi gjuhësore kumulative informacioni, ato mund të jenë të tipave të ndryshëm, si nistoringulloro-shkronjore dhe shkurtesa të tipit rrokjesor. Shkurtesat nuk mund të trajtohen si të krijuara artificialisht në këndvështrimin e ekonomisë gjuhësore ose si një “lojë me fjalët”. Ato shprehin koncepte të reja dhe objekte reale dhe, në këtë mënyrë, pasurojnë gjuhën. Shkurtesat eliminojnë një kontradiktë midis nevojave për të menduar dhe burimeve të kufizuara leksikore të gjuhës. Ato, duke pasur një sinonim leksikor, ndryshojnë prej tij jo vetëm për nga drejtshkrimi, por edhe nga stili. Është e natyrshme që mendimet e gjuhëtarëve ndryshojnë përsa i përket renditjes së problemeve që lidhen me shkurtesat.

“Shkurtesat nuk janë një fenomen i rastësishëm, ato nuk përbëjnë një “deformim të gjuhës”, por janë një proces i rregullt objektiv i përcaktuar nga ndryshimet në nevojat për komunikim për shkak të zhvillimit të shoqërisë dhe modeleve të brendshme të zhvillimit të gjuhës¹⁰. Duke qenë se pjesa më e madhe e shkurtesave kanë të bëjnë me qenien njerëzore dhe sfera të ndryshme të veprimtarisë së tij, faktori njerëzor luan një rol të rëndësishëm në krijimin e tyre dhe është vendimtar për formimin e semantikës, sepse vetëm një qenie njerëzore mund “t’i japë” kuptim një fjale.

Burimi i emërtimeve të shkurtuara

Nocioni i emërtimeve të shkurtuara është shumë përfshirës. Dy janë burimet e krijimit të këtyre njësisë:

¹⁰ Borisov, V. V. (1972). *Abbreviation and acronym formation processes: Military and scientific-technical contractions in foreign languages*. Moscow: Voenizdat.

a. Shkurtimi i emërtimeve të pathjeshta a togfjalëshore që lidhen me botën shqiptare, pra me lëndë nga gjuha shqipe.

b. Huazimi i emërtimeve të shkurtuara (veçanërisht i shkurtesave), si ndërkombëtarizma, nga gjuhët e tjera me nivel të lartë standardizimi dhe përpunimi, sidomos nga gjuhët e Perëndimit (kryesisht nga anglishtja).

Grupi i dytë i këtyre njësive përbën edhe grupin më të madh të emërtimeve të shkurtuara në shqipe, kjo për shkak se vendi ynë ka marrë një zhvillim të paparë e të gjithanshëm, duke qenë i hapur ndaj ekonomisë, ndaj shkencës, ndaj teknikës, ndaj artit, ndaj kulturës etj. të vendeve të tjera. Dhe ashtu si vendi, edhe gjuha është e hapur ndaj gjuhëve të tjera. Nga kontaktet e shumëfishta, të shumanshme dhe të pandërprera në rrjedhë të kohërave me to, shqipja ka marrë nga këto gjuhë shumë emërtime të reja, herë si huazime gjuhësore, herë si huazime kulturore. Kjo ka ndodhur edhe me një pjesë të emërtimeve të shkurtuara.

E megjithatë, krijimi i emërtimeve të shkurtuara është një prirje e brendshme e çdo gjuhe. Shqipja ka qindra a mijëra njësi të tilla që përfshihen në dhjetëra fusha leksikore dhe sot ato po shtohen me shpejtësi të madhe. Këtë shpeshhtësi të përdorimit të tyre e hasim sidomos në median e shkruar, ndërsa në median vizive më së shumti këto emërtime shpërfaqen tek titrat (sipas parimit të dhënies së titullit me sa më pak mjete gjuhësore), si në rastet e titujve: *Vaksinimi i fëmijëve nga 5 deri në 12 vjeç në RMV; EMA konfirmon përdorimin e pilulës Pfizer; OBSH mbledh komitetin e emergjencës; FMN vlerëson rimëkëmben e ekonomisë; FIFA thotë se me VAR-in është rritur koha efektive e lojës; Zgjidhen tre anëtarët më të rinj të KLGJ; SPAK i mbingarkuar, 1 prokuror ka 50 dosje e qindra shembuj të tjerë si këta.*

Ndërsa në median e shkruar emërtimet e shkurtuara gjenden jo vetëm te titujt e lajmeve, por i hasim dendur edhe në brendësi të shkrimit. Këto përdorime variojnë nga emërtime të shkurtuara të njohura për publikun e gjerë, në emërtime pak ose aspak të njohura, si për shembull: *BE bën thirrje për një fillim të ri të marrëdhënieve me SHBA-në; FSHF-së i ngelen llogaritë*

të bllokuara; *Presidenti i KE-së flet për paktin e ri për marrëdhëniet transatlantike*; “*Në një përgjigje për Zërin e Amerikës, zëdhënësi i DASH, Ned Price, tha se Washingtoni është i shqetësuar nga sulmet ...*”; *Vokshi sulmon Bashën: I kanë ngelur vetëm bravat, ka thyer derën e zyrës së LDG*; *Kosovë: Shkarkohet kryetarja e KQZ-së; FBI-ja thotë se është pranë identifikimit të të dyshuarit për vdekjen e policit të Kapitolit; Ekzistojnë UFO-t? Ja çfarë thotë dosja më e shikuar e FBI-së; Kontributi i bujqësisë në PBB u rrit 19.3% në vitin 2020; GDP-ja e Kinës u rrit vjet me 7.8 % etj.*

Tipat kryesorë të shkurtesave dhe denduria e përdorimit të tyre në median e shkruar

Shkurtesat në gjuhën shqipe dhe në gjuhët ku ato gjallojnë si njësi leksikore janë zakonisht njësi emërore. Si të tilla ato mbartin të gjitha kategoritë gramatikore të emrit dhe i kryejnë funksionet sintaksore si dhe emri. Studiuesi Engjëll Angoni pranon se “shkurtesat kanë të gjitha kategoritë gramatikore të emrit: gjininë, numrin, rasën dhe trajtën. Sipas kuptimit mund të jenë emra të përgjithshëm ose të përveçëm¹¹.

Te shkurtesat do të dallojmë dy grupe kryesore sipas formimit: shkurtesa të tipit nistor-tingulloro-shkronjor dhe shkurtesa të tipit rrokjesor. Të dy tipat gjenden dendur në median e shkruar.

Kështu, tipi i parë, shkurtesat e formuara nga shkronjat nistore dallojnë nga emrat e përgjithshëm të zakonshëm, sepse treguesit gramatikorë (mbaresat rasore etj.) këto lloj njësisish të veçanta i marrin në fund, duke mos i bashkuar me temën, por duke i ndarë prej saj me vizë lidhëse. Diferencimin e thellon edhe paraqitja grafike e një pjese të tyre: tema shkruhet me shkronja të mëdha, kurse mbaresat rasore me të vogla, p.sh. *SHBA-ja (SHBA-së), FMN-ja; OBSH-ja; KE-ja; KQZ-ja* e qindra raste të tjera të kudogjendura në media. Megjithatë, siç mund të konstatohet lehtësisht nga të gjithë, përgjithësisht në median e shkruar mungojnë treguesit gramatikorë te këto lloj

¹¹ Angoni, E. “Shkurtesat dhe drejtshkrimi i tyre”, *Gjuha jonë*, 1989, 3, f. 23.

njësish, duke i paraqitur grafikisht vetëm nëpërmjet shkronjave nistore që përbëjnë njëkohësisht temën. Kështu kemi: *Policia rrethoi PD; Lufta ndaj korrupsionit prioritet kyç i SHBA; Bush mban fjalimin para kongresit; Kërkesa e KLGJ për uljen e numrit të gjykatave; Mbretëria e Bashkuar nuk do të paguajë 100 miliardë euro për divorcin nga BE; Investoni në mbrojtjen sociale më të mirë për fëmijët në vështirësi, thotë UNICEF etj.*

Ndryshe ndodh me shkurtesat e tipit të dytë, ato rrokjesore, të cilat përgjithësisht nuk paraqitin probleme, qoftë fjalëformuese, qoftë të karakterit shkrimor apo drejtshkrimor¹², sepse shkruhen si fjalë të zakonshme, me shkronjë nistore të vogël dhe treguesit e eptimit i marrin në fund të temës, pa i ndarë prej tyre me vizë lidhëse. Por në analizën që u kemi bërë emërtimeve të shkurtuara në gjuhën e medias, hasen plot raste të karakterit drejtshkrimor, edhe pse në mediat serioze probleme të tilla hasen më rrallë.

Kështu për shembull: *Albpetrol* (kompani shqiptare e karburanteve) mund të haset në përdorime të larmishme si në shembullin e marrë nga gazeta *Panorama: Albpetrol, sfida e lidershit të ri: Ringritja e sektorit të naftës si rrallë ndonjëherë në 30 vite* (në titull); *Albpetroli do të provojë fort të kontribuojë në ringritjen e Institutit të Studimeve të Naftës.*

Ose: *Digitalb* (platforma digjitale) mund të haset gjithashtu në përdorime të larmishme, si në shembullin e marrë nga *Gazeta Shqiptare: Pas 10 vjetësh edhe Vokshi largohet nga Digitalb* (në titull); *Jonida Vokshi nuk do të jetë më pjesë e Digitalbit* (brenda në shkrim).

Apo *INSTAT: Nivel i lartë varfërie në Shqipëri* (në titull) dhe *Rrezultatet e anketimit të INSTAT mbi nivelet e jetesës në Shqipëri tregojnë se fshati mbetet zona më e varfër dhe e prapambetur e Shqipërisë, sidomos në veri dhe verilindje, por jo më mirë paraqitet gjendja e fshatarit shqiptar edhe në Elbasan dhe Korçë.*

Në punim nuk jemi ndalur te disa probleme që paraqesin emërtimet e shkurtuara gjatë shqiptimit të tyre. Megjithatë,

¹² *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002, f. 74.

vërehet se problem në shqipe krijojnë shkurtesat e huazuara (është huazuar jo vetëm emërtimi i pathjeshtë, por edhe vetë shkurtesa), të cilat kanë në trup shkronja që nuk gjallojnë në këtë gjuhë, ose që kanë shqiptim të ndryshëm. P.sh., *WB6* (*Western Balkan six*) – *BP6*. Është vënë re, se në rastet kur kjo shkurtesë ka qenë pjesë e shkrimit (zakonisht të përkthyer), për shkak të mospërdorimit të gjerë të saj, gazetari ka zgjedhur të përdorë formën e plotë të saj, pra: 6 Vendet e Ballkanit Perëndimor, duke e mënjanuar në tekst shkurtesën *WB6*.

Shkurtesat janë fjalë të mëvetësishme, janë njësi leksikore që mbartin (e që mendojmë se duhet të mbartin) të gjitha tiparet e vlerat e fjalës. Po t'i referohemi akademik J. Thomait kur flet për përcaktimin e “identitetit” të fjalës, të veçorive të saj në të gjitha rrafshet: në atë kuptimor, morfo-strukturor, fjalëformues, fonetik, funksional etj., do të vërejmë se ai i mëshon idesë se asnjë kriter nuk mund të vlejë i vetëm për ta cilësuar ose jo një njësi si fjalë, për këtë duhen vështruar shumë kriterë të gërshetuar së bashku¹³. Janë pikërisht këto tipare që e dallojnë fjalën nga njësitë e tjera gjuhësore. Megjithatë, edhe pse shkurtesat konsiderohen si njësi leksikore që ashtu si dhe fjala duhet të shpërfaqin në gjuhë vlera të ndryshme semantike, emocionore, stilistike, sintagmatike, paradigmatiche a aftësi zëvendësuese, në ndryshim nga fjala shkurtesat nuk shënojnë drejtpërdrejt një përmbajtje, duke qenë se janë shkurtime i një emërtimi të pathjeshtë që shënon një nocion të caktuar, pra përmbajtja mbartet nga emërtimi i thjeshtë të shkurtimeve ose e shprehur ndryshe, një përmbajtje e dhënë sendërtohet me një emërtim togfjalëshor dhe me një fjalë të vetme, e krijuar kjo nga bashkimi i shkronjave a i rrokjeve të fjalëve të këtij emërtimi. Kjo do të thotë që shkurtesa si fjalë nuk dallohet për vlera të mirëfillta semantike.

Po ashtu edhe kur analizojmë vlerat e tjera të fjalëve. Te shkurtesat këto vlera janë gjithmonë të kushtëzuara për shkak se formimet e llojit të tillë janë gjithmonë shkurtime të emërtimeve

¹³ Thomaj, J. (2006). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, f. 31-43.

togfjalëshore dhe shkurtesat përgjithësisht i përkasin ligjëritimit shkrimor.

Këtu duhet të vëmë në dukje një fakt të rëndësishëm: si në gjuhën shqipe, ashtu dhe në gjuhë të tjera indoevropiane, shkurtesat shumë shpesh janë parë ose shihen në kuadrin e fjalëformimit dhe jo në rrafshin leksikografik (si realitete leksikore). Për emërtimet e shkurtuara që nuk sillen në përdorim si fjalë, kundrimi gjuhësor është i paktë. Të rralla janë gjuhët si anglishtja p.sh., që *shkurtesat* (si grup paradigmatic i specifik) i shohin si leksema të mirëfillta dhe si lema të veçanta në fjalorët shpjegues.

Për sa i takon funksionit të emërtimeve të shkurtuara në fjali ato dalin si kryefjalë, si kundrina (me parafjalë e pa parafjalë, të drejta e të zhdrejta), si rrethanorë, si përcaktorë etj.

Nga media ne kemi vjelë dhjetëra shembuj kur këto njësi kanë:

1. Funksion kryefjale: **AMA** (*Autoriteti i Medias Audiovizive*) i transmetoi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë disa ndryshime në ligjin “Për median audiovizive”; Përfaqësuesi i **OSBE-së** për Lirinë e Medias vëzhgon zhvillimet e medias në të 57 Shtetet pjesëmarrëse të **OSBE-së**. Ai bën paralajmërim të hershëm për shkeljet e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias; **BE-ja** thotë se tensionet me Mbretërinë e Bashkuar rrjedhin nga **Brexit**, jo nga protokollin e Irlandës së Veriut; Teksa vendi ndodhet në emergjencë mjekësore, **ARRSH-ja** heq pezullimin e tenderëve për “rrugët elektorale” etj.

2. Funksion kundrine pa parafjalë: **Skenarët e FMN-së**: Nëse nuk frenon shpenzimet, qeveria mund të mbesë pa para; Borxhi mund të arrijë në 88% të **PBB-së**; Shefi i **UNMIK-ut** takon komandantin e ri të **KFOR-it**; **PSSP** Zahir Tanin pret udhëheqësin e ri të misionit të **OSBE-së** në Kosovë; Shqipëria merr për herë të parë presidencën e Komitetit Rajonal të **OBSH-së** për Evropën e dhjetra shembuj të tjerë.

3. Funksion kundrine me parafjalë: Ai citoi një numër vendimesh të marra nga **BE-ja**; Të gjitha vaksinat e prokuruar nën mekanizmin **COVAX** janë aprovuar nga **OBSH-ja** etj.

4. Funkcion përcaktori: *Ja pse ne jemi kundër selisë së re të NATO-s në Belgjikë. Në takim marrin pjesë zyrtarë të lartë të Ministrisë së Jashtme, donatorë, përfaqësuesit e OSBE-së etj.*

5. Funkcion rrethani: *Të dy rivalët politikë brenda PS-së duket se kanë rimarrë pozicionet e konfliktit të fundvitit 2001 etj.*

6. Funkcion ndajshimi: *U vlerësua ndihma që i ka dhënë institucionit të Prokurorisë nëpërmjet misioneve PAMECA dhe EUROALIUS.*

Ashtu si edhe fjalët, por ndryshe nga shkurtimeve e llojeve të tjera, shkurtesat shfaqin, megjithëse minimalisht, edhe aftësi fjalëformuese. Njësia e sapoformuar zakonisht është çastore dhe nuk qëndron si njësi e mëvetësishme. P.sh. kjo dukuri mund të vërehet lehtësisht te formimi *Mini-OKB-ja* në thënien *Amerikanët vlerësojnë sot se administratën ndërkombëtare në Irak duhet ta formojë Mini-OKB-ja e koalicionit antisadam etj.*

Përfundime

Përdorimi i emërtimeve të shkurtuara në gjuhën e shkruar është i lidhur ngushtë në radhë të parë me rolin e mediave në këtë fushë, duke qenë se përdorimi më masiv i tyre bëhet pikërisht nga media e gazetarët. Përderisa emërtimet e shkurtuara tashmë janë realitete gjuhësore dhe sidomos shkurtesat që po bëhen gjithnjë e më shumë pjesë e leksikut, është e natyrshme që në shtypin e përditshëm të gjejmë përdorime të tyre në rritje, pasi vetë natyra informuese e mediave e bën shumë të nevojshëm përdorimin e këtyre llojeve emërtimesh. Kur shkurtesat përdoren me kujdes, si në shembujt që sollëm më sipër, lehtësojnë komunikimin dhe shkurtojnë paraqitjen grafike. Por kemi edhe mjaft raste kur gazetarë joprofesionistë përdorin vend e pa vend shkurtesa të krijuara nga vetë ata ose shumë pak të njohura nga publiku, të cilat përveç se pohojnë formimin e munguar gjuhësor të gazetarit, krijojnë edhe paqartësi te lexuesi. Gazetarët duhet të jenë të vetëdijshëm që jo çdo emërtim i përbërë mund dhe duhet shkurtuar.

BIBLIOGRAFI

- Angoni, E. (1989). “Shkurtesat dhe drejtshkrimi i tyre”, *Gjuha jonë*, 3.
- Borisov, V.V. (1972). *Abbreviation and acronym formation processes: Military and scientific-technical contractions in foreign languages*. Moscow: Voenizdat.
- Çipuri, H. (1988). “Shkurtesat dhe vendi i tyre në terminologjinë e sotme të gjuhës shqipe”, *Studime filologjike*, 3.
- Espersen, O. (1946). *A Modern English Grammar on Historical Principles*. Part VI. Morphology. London, 550-551.
- Garuci, D. (1972). *Mbi drejtshkrimin e shkurttimeve*, Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, Tiranë.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002
- Kondratyukova L.K. (1980). *Computer technologies' formation and development: Dissertation of PhD in Philology*, 17
- Lipka, L. (2013). *Observational linguistics, neologisms, entrenchment, and the Tea Party Movement*. Brno studies in English. 36, 1.
- Marchuk, Y.N. (1992). *Fundamentals of computer-based translation*, 75.
- Martine, A. (1963). “Fundamentals of general linguistics”, *Journal of New in linguistics*, 3, 532-533.
- Memisha, V. (2008). *Emërtimet e shkurtuara në shqipe*. Tiranë.
- Memushaj, R. (2002). *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë.
- Serebrennikov, B.A. (1983). “On materialistic approach to phenomena in language”. *Journal of Science*, Moscow, 319.
- Shehu, H. (1999). *Teknika e leximit në gjuhën angleze*, Tiranë, 1999.
- Trask, L. (2014). *A student's dictionary of language and linguistics*. Routledge.
- Thomaj, J. (2006). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.